

# Vërrshoni në Rrugë: Albanian “Revolution” for Democracy!

Ylli Përmeti

Në një epokë ku qëndrimet dhe bindjet nuk janë të qarta për pothuajse asnjërin, do t’doja të parashtroja disa koncepte bazë të asaj ç’ka ne jetojmë dhe tentojmë të jetojmë nën regjimin e “demokracisë” parlamentare. Kështu, çdo aktivist *dasha-demokrat* duhet të dijë me qartësinë e një mëndjemprehti, se çfarë po kërkojnë “kokonat” tona neoliberalë dhe ku n’a nxjerrë propaganda e tyre “integruese” në BE, dhe ‘*des-integruese*’ nga pushteti i popullit, proklamata kjo e fundit, e Komunistëve tanë pas Luftës së Dytë Botërore, por e dështuar totalisht. Disa nga arsyt bazë përse ata dështuan, tashmë i kam cituar në vend tjetër<sup>1</sup>, analitikisht. Ajo që dua të citoj këtu është qëllimi i projektit neoliberal dhe qëllimi ynë brenda këtij projekti.

Kështu, projekti neo-liberal, është një projekt i cili i shërben totalisht oligarikisë globale, ose konsensusit të Uashingtonit, ku përmes shumë pushteteve të nën-kuptuar, juridikë, politikë, ekonomikë dhe normativo-instrumentalë, duan të fusin nën ombrellën e kësaj oligarkie, dinamikën e punëtorit dhe shfrytëzimin e tij –projekt i cili është nën mbikqyrjen e pronarëve të bankave, shumë-kombsheve, mjeteve të prodhimit, burimeve natyrore-kombëtare etj., individë këta që gjenden në vende të ndryshme të botës (ndaj dhe shohim privatizim të shfrenuar në të gjithë botën dhe me ritme tejet katapultive në Shqipëri). Krijimi i kësaj oligarkie nuk është i planifikuar në ndonjë laborator, por është kapitalizmi dhe dinamika e tij që çon dhe krijon oligarki të këtij lloji (vëndor dhe global), të padëshmuar ndonjë herë në historinë tonë humane. Këta individë tashmë, kanë mundësi, çdo sekondë të 24 orëshit të krijojnë/nxisin

luftra, epidemi, shfarrosje, dhe të kërcënojnë seriozisht jetën e planetit tonë mbi tokë. Këtë shkatërrim dhe luftë të pandërprerë e dëshmon gjithkush nga ne. Arsyet janë të shumta: janë një mori instrumentesh politiko-ekonomiko-juridikë, të cilët janë prezantuar gradualisht qoftë nën një regjim ish-shtetëror, qoftë nën një regjim *supernacional*<sup>ii</sup>/federal të sotëm. Nuk do të citojmë këtu instrumentet dhe doktrinën, për arsye evidente, por luftën dhe mirë-qënien e popullit të lirë, i cili nën një regjim oligark, nuk ka mundësi të jetë i lirë dhe i mirëqëndshëm, për arsye të qarta nga të gjithë ne.

Në fjalë të tjera: populli në një regjim oligark, normativizohet për një periudhë katër-vjeçare të votojës, ku përgjatë po të njëjtës periudhë, ai shfytëzohet deri në palcë, nga dinamika e kapitalit, përtej qëllimeve subjektive të individëve që dominojnë oligarikinë dhe monopolet apo lirinë që gjoja 'ofrojnë' (sikur të ishin zotërit e kësaj bote) mbi një popull autokton. Pra populli, nuk merr pjesë në politikë-bërje, ashtu siç bënte sa herë binin perandoritë e fashistëve të ndryshëm që shfaqeshin në horizont, por *vetëm* voton, sa herë partitë ua kërkojnë këtë me Kushtetutë –jo popullore (gjenealogjike), por normative, dmth, të qëndisur sipas orekseve të Perandorit. Dhe në këtë mënyrë, degjeneron gjithçka: familja, shoqëria dhe universi. Duhet të kuptojë gjithkush se nëse nuk e kontrollon (mendimin) familjen përmes dialogut familjar, ajo degjeneron, ose ka për prirje, të kthehet në një familje ku shqetësimet dhe nevojat e çdokujt të mos plotësohen apo të mos njihen, sikurse kjo ngrehinë nënkupton, por sjell zvjerdhen e saj. Një lloj edhe shoqëria: populli dialogon mendimin e tjetrit (politikanëve), jo të tijin, duke e zvjerdhur atë nga familja e madhe e një shoqërie homogjene, sikurse është shoqëria shqiptare. Kjo dukuri çon në implikime të mëtejshme: manipulime shoqërore përmes institucioneve që ajo ushqen me djersën e saj.

Në fakt, ky është objektivi i oligarkisë: t'a zvjerdhin popullin nga politika, pra t'a jashtë-qisin atë, dhe t'a përdorin atë sa herë që kanë nevojë për të, pra për kapital. Kështu, qëllimi ynë, nuk duhet të jetë thjesht për rrëzimin e personave nga pushteti, **por ndryshimin e regjimit: nga oligark, në popullor.** Hapi i parë është shumë i thjeshtë për t'u ndërmarrë: Neni 2, pika 2, i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se 'Populli e ushtron sovranitetin e tij nëpërmjet

përfaqësuseve të tij ose drejtpërsëdrejti'. Kjo normë duhet të përmbysset: *populli e ushtron sovranitetin e tij drejtpërsëdrejti si fillim dhe pastaj nëpërmjet përfaqësuesve të tij*. Kjo përmbysje do të minimizojë së pari manipulimin në të gjithë gamën e tij, dhe së dyti, do të ofrojë koherencë në vendim-marrje. Modeli tashmë është paraqitur, pavarësisht se Universitetet tona, nuk kanë lëvizur asnjë gur për t'a didaktuar te të rinjt tanë, kur ndërkohë, Univeristete të tjerë, si psh, Oksfordi, e didakton!<sup>iii</sup>

Kështu, aktivistët duhet të adoptojnë udhëheqjen e bisedave/diskurseve popullore; prezantimin e reformave dhe rrahjen e tyre me popullin, në bashkëpunim me specialistë shkencor, dhe vendim-marrja duhet të jetë popullore dhe e formës që vijon: po, kjo është dëshira ime, dhe kjo është ajo që dëshiroj. Nëse një vendim-marrje nuk arrinë në këtë stad, ajo është prirur që të dështoj. Prandaj, aktivistët e epokës sonë duhet të jenë së pari të pajisur me aftësi argumentative, shkencore dhe të thjeshta njëkohësisht; dhe së dyti, ithtarë dialogjikë. *Qëllimi final i një diskursi duhet të jetë barazia materiale e individëve, organizmi i ekonomisë, të cilën tashmë e kemi ravijëzuar, sipas natyrës së saj, liria, autonomia individuale dhe periferike, eliminimi i klasave, racionalizmi i vendimeve, për të cilin ofrojmë pyetje shumë të thjeshta, dhe që kërkojnë përgjigje, në popull të hapur, dhe unifikim vendimi që mos të dyshohet pothuajse nga askush*. Dhe kështu, të tjerat, vijnë më pas...

Pra, aktivistët e pushtetit të popullit, nuk duhet vetëm të kundërshtojnë kapitalizmin por edhe të "kërkojnë" pushtet nga populli që t'a kthejnë atë: te populli, përmes vendimeve popullore. Një aktivist i tillë, nuk ka nevojë për vota, sepse ai/ajo e ka prirje të udhëheq vendim-marrjen, bashkë me popullin. Nëse ne arrijmë dhe bëhemi shumë të tillë, atëherë ne kemi bër një hop mjaft historik: ne i çojmë pushtetin ekonomiko-politikë popullit, ashtu siç ia "rrëmbeu" dikur shteti konvencional. Duke bër diçka të tillë, ne jo vetëm që eliminojmë varfërinë, mos-marrveshjet, gënjeshttrat, manipulimet dhe oligarikinë vendore, por ne eliminojmë oligarkinë globale, që tashmë është kthyer në barbarizëm dhe do të jetë shumë më e dhimbshme në të ardhmen nëse ne vazhdojmë t'a lëmë të *injektohet* në shoqërinë

tonë. Ne gjithashtu, do të jemi kryelartë për demokracinë tonë popullore, sepse ne do të kemi nevojë për një-tjetrin, një lloj si një femër për një mashkull dhe e kundërta.

Nëse në anën tjetër, dikush demokracinë popullore e sheh si përbuzje apo mediokritet, atëherë, ne, si aktivistë, i përbuzim një lloj, sepse pikërisht, ata nuk i njohin të gjitha, dhe shtysa që i shtynë ata –të jenë të tillë, është paraja dhe shfrytëzimi manipulativ nën ombrellën e oligarkëve. Individë të tillë, një shoqëri providente, i jashtë-qit mjaft mirë me ostracizëm. Prandaj, në 10 Qershor, nuk do të jetë një protestë kundër personave që kemi në pushtet apo atyre që duan të vinë në pushtet, respektivisht, PS, të cilët janë ana tjetër e së njëjtës monedhë, por kundër gjithçkaje, që të parët tanë kanë ndërtuar në funksion të oligarkisë dhe shfrytëzimit të punëtorit në dëm të së ardhmes tonë. Vetëm ky është Revolucion –pa thonjëza: të tjerat janë gërvishtje të sistemit.

---

<sup>i</sup> Shih *Ylli Përmeti, Përtej Ekonomisë së Tregut dhe Planit Shtetëror: Drejt një Ekonomi dhe Demokraci 'Fronetike', ff, 21-24.*

<sup>ii</sup> Për një detajim të nocionit juridik suprancional, shih *Ylli Përmeti, Ligjet dhe Kushtetutat: Të tejkalosh Natyralizmin, nën Publikim.*

<sup>iii</sup> Oksfordi, didakton qoftë Platformën e Fotopulos, qoftë atë të Flyvbjerg, e cila nuk kontribun në ekonomi, por vetëm në filozofi.